



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Durrës, më 20.10.2025

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës – Shërbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Mirëmbajtje për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):
Shërbime për krijim programesh për përpunim të investimeve dhe të deklarimeve të taksave
72212410-6

VLERA E FONDIT LIMIT: 4.989.800 (katër milion e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind) Lek pa TVSH.

Argumentim:

MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E
VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Në zbatim të urdhrit Nr.320, datë 03/10/2025, e nr. 11966 prot., të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për tu kryer në programet e shpenzimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

- a. Grumbullimin e informacionit, lidhur me shqyrtimin e Specifikimeve Teknike të shërbimit, objekt i këtij prokurimi, si dhe
- b. Grumbullimin e informacionit, lidhur me çmimet orientuese në treg, në mënyrë për të përllogaritur vlerën limit të kontratës.

I. PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Për shqyrtimin e specifikimeve teknike, komisioni u mbështet në informacionin e marrë nga:

- a. Materialet e ofruar nga investimet e mëparshme dhe duke u mbështetur në tregun vendas.

Pas shqyrtimit të informacionit mbi të dhënat teknike komisioni vërejtë se:
Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12. 2020, “Për Prokurimin Publik”, neni 40.

II. PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, Mbështetur në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM, Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76, sipas të cilit:

Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe:

- b. a) Preventiv i çmimeve sipas studimit të çmimeve të tregut bazuar Materialet e ofruar nga investimet e mëparshme dhe duke u mbështetur ne tregun vendas.
- b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Komisioni organizoi punën për kërkimin dhe grumbullimin e informacionit mbi çmimet orientuese për shërbimin, objekt i këtij prokurimi;

Në përfundim të kërkimeve, u vërejt se:

- 1. Grupi i punës u bazua në analizat e hartuar nga vetë grupi bazuar në materialet e ofruara nga investimet e mëparshme dhe duke u mbështetur ne tregun vendas.
- 2. Lista e publikuar nga AKSHI, nuk përmbajne te dhena mbi cmimet e ketij projekti.
- 3. Institucionet e tjera zyrtare, te njohura nuk disponojne publikime lidhur me cfare kerkohet.

Në përfundim, pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit tregtar dhe pasi i përpunoi ato në një tabelë të grumbullimit të zërave bazuar në një metodologji të paracaktuar, rezultoi se vlera e përgjithshme e kontratës për prokurimin me titull: ” Mirëmbajtje për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore” të jetë: 4.989.800 (katër milion e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind) Lek pa TVSH.

Afati shërbimit: 1 (një) vit/ 12 (dymbëdhjetë) muaj.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

II. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme, (sipas shtojcës 9).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së, i ndryshuar, nenin 41, pika 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 41 pika 2, nenit 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 41 pika 2 ku përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës” dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave” duke qenë se vlera e fondit limit të objektit përkatës është nën kufirin e ulët monetar kriteri hartohet në përputhje me vlerën procedurës. Referuar sa më sipër duke qenë se vlera e fondit limit objektin është nën kufirin e ulët monetar që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur e thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 55 pika 4 e VKM Nr.285, dt.19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2025 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e dokumentit që vërteton se operatori ekonomik i ka shlyer të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025 është përcaktuar në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe me nenin 43, 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter mbështetet gjithashtu në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, konkretisht në nenin 5, pika “c”, sipas të cilit subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike kanë detyrimin të shlyejnë taksat dhe tarifatat vendore ndaj njësisë së qeverisjes vendore ku ushtrojnë aktivitetin, në përputhje me afatet e miratuara nga këshillat bashkiakë përkatës. Ky kriter garanton që

operatori ekonomik që merr pjesë në procedurën e prokurimit është një subjekt i rregullt në kuptimin fiskal dhe administrativ, që respekton detyrimet ligjore dhe financiare ndaj autoriteteve vendore. Përmbushja e këtij detyrimi tregon seriozitet, përgjegjshmëri dhe stabilitet financiar të operatorit ekonomik, duke reduktuar rrezikun që një operator me detyrime të papaguara të mos jetë në gjendje të përmbushë me korrektësi dhe në kohë kontratën e prokurimit publik. Në përputhje me dispozitat e nenit 26 të VKM-së nr. 285/2021, verifikimi i këtij kriteri mund të bëhet nëpërmjet dokumenteve të lëshuara nga administrata tatimore vendore ose përmes vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 9 e DST). Kjo formë është në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe të lehtësimit administrativ të procedurave të prokurimit publik, duke i mundësuar operatorit ekonomik të vetëdeklarojë përmbushjen e detyrimeve, ndërkohë që autoriteti kontraktor mban të drejtën e verifikimit të mëtejshëm pranë organeve përkatëse. Për shkak se objekti i kontratës lidhet me furnizimin e mallrave specifike për nevojat e emergjencës civile dhe shërbimit zjarrfikës, është e domosdoshme që operatorët ekonomikë të jenë në rregull me detyrimet e tyre fiskale dhe vendore, në mënyrë që të sigurohet stabiliteti financiar dhe aftësia e tyre për të përmbushur në kohë dhe cilësi kërkesat e autoritetit kontraktor. Një operator me detyrime të papaguara ndaj njërive të qeverisjes vendore mund të konsiderohet me risk të lartë financiar, gjë që do të cenonte zbatimin e kontratës dhe interesin publik. Në përfundim, ky kriter është proporcional, ligjërish i bazuar dhe teknikisht i domosdoshëm, pasi siguron që në procedurë të marrin pjesë vetëm operatorë që janë në përputhje me legjislacionin tatimor dhe vendore, duke mbrojtur integritetin dhe barazinë në garë të prokurimeve publike.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit të kontratës. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kriteri i përcaktuar më sipër mbështetet në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 55, pika 4, germa “b” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Sipas këtyre dispozitave, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë nga operatorët ekonomikë prova që vërtetojnë përvojën e mëparshme të ngjashme me objektin e kontratës, me qëllim të sigurohet se ofertuesi zotëron kapacitetin teknik dhe profesional për realizimin e kontratës që prokurohet. Kjo kërkesë është e proporcionuar me natyrën e kontratës, pasi objekti

“Mirëmbajtje për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore” përfshin shërbime që kërkojnë njohuri dhe eksperiencë specifike në administrimin e sistemeve informatike të përdorura nga administrata vendore, përfshirë elemente si: mirëmbajtje software-i, mbështetje teknike, siguri e të dhënave dhe shërbime integrimi me module të tjera fiskale. Përvoja e mëparshme në shërbime të ngjashme është tregues thelbësor për aftësinë e operatorit për të ofruar shërbime pa ndërprerje, për të siguruar vazhdimësi funksionale dhe për të reaguar me efikasitet ndaj problematikave teknike gjatë zbatimit të kontratës. Përcaktimi i vlerës minimale prej 20% të fondit limit është bërë në përputhje me kufijtë e përcaktuar në nenin 55, pika 4, germa “b” të VKM nr. 285/2021, dhe konsiderohet i arsyeshëm për këtë lloj shërbimi, pasi: siguron që operatori të ketë përvojë të mjaftueshme, por pa kufizuar konkurrencën; përjashton kërkesa të tepruara që do të favorizonin vetëm subjekte të mëdha; lejon pjesëmarrjen e operatorëve që kanë kapacitete reale dhe referenca të ngjashme për mirëmbajtje sistemesh tatimore ose financiare. Në këtë mënyrë, kriteri është në përputhje me parimet e ligjit për prokurimin publik, veçanërisht me ato të barazisë së trajtimit, konkurrencës së ndershme dhe proporcionalitetit, duke i mundësuar autoritetit kontraktor të vlerësojë objektivisht aftësinë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë për të përmbushur me sukses kontratën në fjalë.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

a. Punonjës për sistemin e operimit Oracle Linux ose ekuivalent 2(dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës me certifikim për sistemin e operimit Oracle Linux (ose ekuivalent) në të cilin është instaluar sistemi i menaxhimit financiar. Te deshmohen me certifikatat perkatese.

Argumentim: *Per te garantuar sherbime te suksesshme gjate mirëmbajtjes se sistemit financiar Oracle E-Business Suite R12.2, eshte e domosdoshme qe operatori ekonomik fitues te kete punonjës te certifikuar per sistemin e operimit Oracle Linux (ose ekuivalent) ne te cilin eshte i instaluar sistemi i menaxhimit financiar*

b. Punonjës për implementimin e bazave të të dhënave Oracle ose ekuivalent 2(dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës me certifikim për implementimin e bazave të të dhënave Oracle (ose ekuivalent). Te deshmohen me certifikatat perkatese.

Argumentim: *Duke qene se gjate mirëmbajtjes se sistemit financiar mund te jete e nevojshme te behen ndryshime ne aspektin e implementimit te bazes se te dhenave te sistemit te menaxhimit financiar , eshte e domosdoshme qe operatori ekonomik fitues te kete punonjës te certifikuar per implementimin e bazave të të dhënave Oracle (ose ekuivalent).*

c. Punonjës për administrimin e bazave të të dhënave Oracle ose ekuivalent 2(dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës me certifikim për administrimin e bazave të të dhënave Oracle (ose ekuivalent). Te deshmohen me certifikatat perkatese.

Argumentim: *Per te garantuar sherbime te suksesshme gjate mirëmbajtjes se sistemit financiar Oracle E-Business Suite R12.2 i cili i regjistron te dhenat ne nje baze te dhenash Oracle database , eshte e domosdoshme qe operatori ekonomik fitues te kete punonjës te certifikuar per administrimin e bazave të të dhënave Oracle (ose ekuivalent).*

d. Punonjës për zhvillim software-i ne Oracle PL/SQL ose ekuivalent 2(dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës me certifikim per zhvillim software-i ne Oracle PL/SQL (ose ekuivalent). Te deshmohen me certifikatat perkatese.

Argumentim: *Duke qene se gjate mirëmbajtjes se sistemit financiar mund te jete e nevojshme te behen ndryshime ne aspektin programativ ne nivel baze te dhenash, sikunder dhe gjate sherbimit te mirembajtjes do te duhet te mirembahen paketat (database packages), atehere eshte e domosdoshme qe operatori ekonomik fitues te kete punonjës te certifikuar per zhvillim software-i ne Oracle PL/SQL (ose ekuivalent).*

e. Punonjës për zhvillim software-i ne Oracle Forms ose ekuivalent 2(dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës te certifikuar per zhvillim software-i ne Oracle Forms (ose ekuivalent). Te deshmohen me certifikatat perkatese.

Argumentim: *Duke qene se gjate mirëmbajtjes se sistemit financiar mund te jete e nevojshme te behen ndryshime ne aspektin e programimeve te formave te sistemit, sikunder dhe gjate sherbimit te mirembajtjes do te duhet te mirembahen format (application forms), atehere eshte e domosdoshme qe operatori ekonomik fitues te kete punonjës te certifikuar per zhvillim software-i ne Oracle Forms (ose ekuivalent).*

f. Punonjës për (General Ledger), (Payables), (Receivables) ose ekuivalent 2 (dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës te certifikuar nga Oracle per implementimin e modulit e Librit te Madh (General Ledger) ose ekuivalent, te Pagueshmeve (Payables) ose ekivalent, te Arketueshmeve (Receivables) ose ekuivalent. Te deshmohen me certifikatat perkatese.

Argumentim: *Per te garantuar sherbime te suksesshme gjate mirëmbajtjes se sistemit financiar Oracle E-Business Suite R12.2, eshte e domosdoshme qe operatori ekonomik fitues te kete punonjës te certifikuar per implementimin per secilin nga modulet ne vijim; te modulit e Librit te Madh (General Ledger) ose ekuivalent, te Pagueshmeve (Payables) ose ekuivalent, te Arketueshmeve (Receivables) ose ekuivalent, per te garantuar sherbime te suksesshme gjate zbatimit te kontrates.*

g. Punonjës për të certifikuar për virtualizim ose ekuivalent 2 (dy)

Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për virtualizim ose ekuivalent;

Argumentimi: *Një punonjës i certifikuar për virtualizim ka njohuri të specializuara dhe përvojë në fushën e virtualizimit, duke përfshirë njohuri të thella të teknologjive të virtualizimit, siç janë platformat e virtualizimit, mjetet për menaxhimin e burimeve virtualizuese, dhe*

praktikat më të mira për implementimin e infrastrukturës së virtualizuar. Virtualizimi sjell sfida të veçanta në sigurinë dhe stabilitetin e sistemit, siç janë mbrojtja e masës së virtualizuar dhe parandalimi i incidenteve të sigurisë. Dy punonjës të certifikuar për virtualizim kanë njohuri të specializuara për të adresuar këto sfida dhe për të siguruar një infrastrukturë të sigurt dhe stabile të virtualizimit.

h. Punonjës të të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente **1 (nje)**

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente.

Argumentim: Operatori ekonomik duhet të ketë patjetër te paktën një person të certifikuar si menaxher projekti, për të siguruar zhvillimin e suksesshëm dhe me rigorozitet të projektit të mirëmbajtjes së sistemit financiar.

i. Punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente) 1 (nje)

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente).

Argumentim: Për të siguruar mbarëvajtjen e kontratës nga aspekti i menaxhimit të ofrimit me cilësi të shërbimeve bazuar në metodologji botërore, operatori ekonomik duhet të vendosë në dispozicion të projektit një punonjës të certifikuar ITIL ose ekuivalent. Kërkesa për certifikim ITIL ose ekuivalente, i dëshmon autoritetit që operatori ekonomik, nëpërmjet stafit të certifikuar si më sipër, garanton ideimin dhe konceptimin e shërbimeve IT të projektit në mënyrë të menaxhueshme sipas standardeve ndërkombëtare të njohura, në gjithë ciklin e tyre.

Për të dëshmuar përmbushjen e ketyre kritereve me sipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Certifikimet që vertetojnë kualifikimin e personelit.

Personeli i mësipërm duhet të ketë aktualisht një marrëdhënie pune me ofertuesin jo me pak se 1 (nje) muaj, e vërtetuar kjo me formularet E-sig të listëpagesave të konfirmuara pranë autoriteteve tatimore.

Kriteret më lartë (nga 2.3.2 a-i), quhen të përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë personel prej minimalisht 12 persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të disponojë (te paraqesë):

- a) ISO 9001:2015 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme)
- b) ISO 27001:2022 ose ekuivalente për Sigurinë e Informacionit (e vlefshme)
- c) ISO/IEC 20000-1:2011 ose ekuivalente (për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit).

Argumentimi: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Certifikimi **ISO 9001:2015** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilesore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësive implementuese.

Certifikimi **ISO 27001:2022** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe e kanë një rëndësi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikepamja informatike dhe të jenë të kontrolluara dhe si dhe aksesimi mbi to të jetë i verifikueshëm dhe i kodifikuar). Kjo vjen pasi në këtë kontratë do të ketë edhe furnizime të reja ashtu si edhe mirëmbajtje dhe upgrade të sistemeve ekzistuese që kërkojnë kompetencë të shtuar profesionale në këtë drejtim.

Certifikimi **ISO 20001-1:2011** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qenë se zoteron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjisë së informacionit, duke pasur me shumë garanci që ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë të gjithë sistemin në teresi i cili është teresisht i bazuar në produkte TIK (software dhe hardware);

2.4.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë partneritet të vlefshëm me Oracle.

Argumentim: Meqenëse si objekt i kësaj kontrate kërkohet të realizohet mirëmbajtja e sistemit financiar Oracle E-Business Suite R12.2 që Bashkia e Durrës disponon, është e domosdoshme që operatori fitues të ketë partneritet të vlefshëm me Oracle, për të kryer me sukses dhe cilesisht shërbimet e objektit kontratë.

2.5 Kriter për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45, Seksioni III Kërkesa të veçanta sipas tipeve të kontratave, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”:

Për punë /mallra/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjëndura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, **bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave...**”

III. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nevojat reale të Bashkisë Durrës për mirëmbajtjen e sistemit financiar Oracle E-Business Suite R12.2, që përdoret për administrimin e të gjitha proceseve financiare, buxhetore dhe tatimore të institucionit. Ato përcaktojnë qartë kërkesat për garantimin e funksionimit të pandërprerë, sigurisë së të dhënave, përditësimit të moduleve ekzistuese, si dhe integrimin me sistemet ndihmëse si menaxhimi i taksave, gjobave, aseteve dhe burimeve njerëzore. Këto specifikime janë të domosdoshme dhe proporcionale me kompleksitetin e sistemit, duke siguruar që operatori ekonomik të ofrojë shërbim të vazhdueshëm dhe profesional, në përputhje me standardet teknike të Oracle dhe me kërkesat ligjore për administrimin financiar në njësitë e qeverisjes vendore. Në këtë mënyrë, specifikimet teknike garantojnë vijimësinë operacionale, transparencën e proceseve financiare dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike të të dhënave të Bashkisë Durrës. Bazuar në specifikimet teknike të hartuara nga struktura e posaçme e ngritur me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor konstatohet se plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 41 pika 2 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në këto kushte njësia e prokurimit po publikon specifikimet teknike. Kujdes! Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike dhe fondi limit i kontratës janë hartuar prej Autoritetit Kontraktor për nevojat e së cilës po kryhet kjo procedurë prokurimi.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit